



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MAJLINDA DEMOLLARI  
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE  
NR.5, RR. VASO PASHA, GODINA NR.  
1, APARTAMENTI NR.3, HYRJA  
NR .10  
TEL: 0682061560

## KONTRATA TË TJERA

Nr. repertori: 8375

Nr. koleksioni: 2761

Tirane më 18/10/2024

Majlinda  
Demollari

Firmosur elektronikisht nga  
NISA me certifikatën  
Majlinda Demollari  
Data: 2024.10.18  
16:51:41+02:00

Ligjet referuese:

1. Ligji nr. 7850, datë 29-07-1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
2. Ligji nr. 9887, datë 10-03-2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
3. Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024053790295837720

\*Akti noterial përbëhet nga 18 fletë

Majlinda E. Demollari  
Taksa e Pultes  
U. Paqwa



A2024053790295837720

## KONTRATË E SHOQËRISË SË THJESHTË

Sot, më datë 17.10.2024 (dymijë e njëzet e katër) para meje Notere Majlinda Demollari, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tirane, me zyrë në adresën Tirane, rruga "Vaso Pasha", u paraqiten personalisht:

**Shoqëria "MS CONSTRUCTION SHPK"**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M11923006V, me adresë Rruga "Qemal Stafa", Pallati 25, Hyrja 4, Apartamenti 4, përballë Qendrës Lincoln, njësia Bashkiake Nr.8, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Sokol Metoja, atësia Mustafa, amësia Bukuriye, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Blv. Zhanë D'ark; Nd. 107; H. 1; Njësia Administrative Nr. 3; Njësia Bashkiake Nr. 3; 1005; Tiranë, lindur më 18/06/1982, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032706806 dhe nr. personal I20618075A.

**Shoqëria "RS CONSTRUCTION & ENGINEERING" SHPK**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M11609022Q, me adresë Rruga Ismail Qemali, Ap.22, Nr. Pasurie 2/827+1-22, Zona Kadastrale 8270, Vol.81, Fq 234, përfaqësuar nga Administratori Roland Sinjari, atësia Kastriot, amësia Pranvera, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnjë, Lushnje dhe banues në TIRANË, me adresë Ndre Mjeda; Nd. 53; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 08/11/1984, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035787089 dhe nr. personal I41108079R.

Në vijim referuar veçmas si "Pala" ose "Anëtari" dhe bashkërisht si "Palët" ose "Anetarët",

### Rrethanat e Hartimit të Aktit Noterial:

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për kalimin e të drejtave. Unë noterja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

### DEKLARIME PARAPRAKE

- Palët pjesëmarrëse në këtë kontratë, në bazë të dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, duke shprehur vullnetin e tyre të lirë deklaruan se janë dakort të bashkëpunojnë duke investuar së bashku me qëllim Zhvillimin e Projektit Rezidencial në zonën e Rradhimës.
- Për realizimin e këtij qëllimi, palët do të vënë në dispozicion para, sende, njohuri pratike dhe aftësi, ekspertizë, apo shërbime sipas përcaktimeve të kësaj kontrate.
- Palët do të shpërndajne fitimin sipas përcaktimeve të dispozitave këtu më poshtë parashikuar.

R



## NENI 1

### ANËTARËT E SHOQËRISË SË THJESHTË

Anëtarët e "Shoqërisë së Thjeshtë" janë:

Shoqëria **MS CONSTRUCTION SHPK**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M11923006V, me adresë Rruga "Qemal Stafa", pallati 25, hyrja 4, apartamenti 4, përballë Qendrës Lincoln, Njësia Bashkiake nr.8, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Sokol Metoja, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr. Personal I20618075A (më tej referuar si Anëtar I).

DHE

Shoqëria **RS CONSTRUCTION & ENGINEERING SHPK**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M11609022Q, me adresë Rruga "Ismail Qemali", Ap.22, Nr. Pasurie 2/827+1-22, Zona Kadastrale 8270, Vol.81, Fq 234, përfaqësuar nga Administratori Roland Sinjari, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr. Personal I41108079R (më tej referuar si Anëtar II).

## NENI 2

### EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë të Thjeshtë është "Rever Investment and Development".

## NENI 3

### SELIA DHE DEGËT

1. Selia e Shoqërisë së Thjeshtë është në adresën: Rruga "Ismail Qemali", Ap.22, Nr. Pasurie 2/827+1-22, Zona Kadastrale 8270, Vol.81, Fq 234, Tiranë.
2. Shoqëria e thjeshtë mund të vendosë të hapë degë dhe/ose filiale dhe/ose adresa sekondare dhe/ose zyra përfaqësimi të shoqërisë si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj ose mund të çregjistrojë ato ekzistuese sipas ligjeve në fuqi me Vendim të Administratorit/eve.
3. Shoqëria e thjeshtë mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashtë saj me Vendim të Administratorit/eve.

## NENI 4

### FORMA LIGJORE

Shoqëria është e themeluar si shoqëri e thjeshtë në përputhje me dispozitat e Kodit Civil Shqiptar dhe legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.



## NENI 5

### KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË

1. Veprimtaria e shoqërisë së thjeshtë fillon me rregjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).
2. Afati i veprimtarisë së shoqërisë së thjeshtë, është për një afat të pacaktuar deri në përmbushjen e qëllimit dhe objektit të saj. Në çdo rast, afati i shoqërisë së thjeshtë do të zgjatet deri në rregullimin e të gjitha llojeve të llogarive me punëmarrësit dhe çdo palë të tretë, ose ndërmjet vetë anëtarëve të Shoqërisë të Thjeshtë si dhe kthimin e garancive përkatëse dhe letrave të garancive dhe deri në mbledhjen e të gjitha kërkesave të arkëtueshme në përgjithësi nga Shoqëria e Thjeshtë dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve të saj ndaj çdo Autoriteti, person juridik ose fizik, si dhe deri në përfundimin e auditimit të saj tatimor, duke përfshirë edhe ndonjë çështje të pazgjidhur që lidhet me kontributet e sigurimeve.
3. Me kryerjen dhe përmbushjen e detyrimeve të sipërpërmendura, Shoqëria e Thjeshtë do të konsiderohet, e shpërbërë dhe do të likujdohet nga Administratori/ët e saj.

## NENI 6

### QËLLIMI DHE OBJEKTI

1. Qëllimi i Shoqërisë së Thjeshtë është Investimi dhe Zhvillimi i Projektit Rezidencial në zonën e Rradhimës.

## NENI 7

### PJESËMARRJA NË SHOQËRINË E THJESHTË

1. Përqindjet e kontributit të Palëve në Shoqërinë e Thjeshtë do të jenë:
  - a) Anëtari I Shoqëria "MS CONSTRUCTION" SHPK-50%
  - b) Anetari II Shoqëria "RS CONSTRUCTION & ENGINEERING" SHPK-50%
2. Të njëjtat kuota pjesëmarrje do të aplikohen gjithashtu në rastin kur Shoqëria e Thjeshtë ndërmerr të kryejë çdo punë të re ose shtesë për këtë Projekt në çdo mënyrë.
3. Anëtarët bien dakord se garantimi i detyrimeve kundrejt të treta lidhur me pjesëmarrjen me sipër si dhe fitimi do të ndahet midis tyre sipas përqindjes së pjesëmarrjes së parashikuar këtu më sipër.
4. Ndalohet rreptësisht për të zgjeruar Shoqërinë e Thjeshtë përmes pjesëmarrjes së një apo më shumë anëtarëve shtesë në të pa marr paraprakisht pëlqimin nëpërmjet vendimit unanim të të dy anëtarëve të Shoqërisë së Thjeshtë.
5. Asnjë nga palët kontraktuese nuk ka të drejtën për të transferuar tek një palë e tretë, në asnjë mënyrë dhe për çfarëdo arsye, kuotat e saj të pjesëmarrjes në Shoqërinë e Thjeshtë, dhe as nuk ka të drejtë të transferojë të drejtat e veta që rrjedhin nga kjo Kontratë e Shoqërisë të Thjeshtë, pa miratimin paraprak të veçantë dhe me shkrim të Anëtarit tjetër.



## NENI 8

### TË DREJTA DHE DETYRIME TË PËRBASHKËTA TË ANËTARËVE

1. Te dy anetaret do te percaktojne bashkerisht politiken per arritjen e objektit dhe qellimit te saj dhe do te marrin vendimet mbi ceshtjet themelore qe lidhen me Shoqerine e Thjeshte.
2. Ceshtjet themelore te parashikuara ne piken 1 ketu me siper perfshijne, por nuk kufizohen ne sa me poshte vijon:
  - a. kushtet dhe afatet e nevojshme per realizimin dhe koordinimin e zhvillimit te Projektit Rezidencial ne zonen e Rradhimes;
  - b. pranimi i vleres financiare si dhe parashikimi i buxhetit qe nevojitet per realizimin e tyre;
  - c. caktimi i metodes se perzgjedhjes dhe kushtet e pajtimit dhe te perfundimit te kontratave te sherbimit me Specialiste te nevojshem.
  - d. ndryshimet, devijimet apo heqja dore nga nje vendim mbi nje ceshtje themelore per te cilen Anetaret kane rene dakort, deri ne masen qe ky ndryshim, devijim apo heqje dore ka nje efekt material;
  - e. çdo modifikim ose ndryshim gjate Sherbimeve qe mund te ndikojne ne (i) qellimin e shoqerise se thjeshte, (ii) objektin e saj ose (iii) kushtet financiare;
  - f. ndjekja e pretendimeve ne lidhje me Shoqerine e Thjeshte;
  - g. çdo veprim tjeter apo ngjarje qe nuk perfshihet ne drejtimin e zakonshem te perditshem te Shoqerise se Thjeshte ose te nenkuptuar ose kuptuar ne ndonje vendim mbi nje ceshtje thelbesore te marre tashme nga Anetaret.
3. Anetaret do te takohen sa here qe ata deshirojne apo e konsiderojne te nevojshme per administrimin e veprimtarise se Shoqerise se Thjeshte ne nje kohe te pershtatshme dhe ne nje vend te pershtatshem per te dy palet.
4. Secila prej Shoqerive Anetare mund te kontraktohet per te kryer punime per projektin sipas Marreveshjeve ne zbatim te zhvillimit te punimeve.
5. Anetaret gjithashtu mund te kontraktojne pale te treta per kryerjen e sherbimeve te tyre, profesioniste ne rolin e konsulenteve, menaxhereve dhe kontraktoreve ne perputhje me nevojat qe mund te lindin per kryerjen sa me te pershtatshme te detyrave te tyre sipas qellimit te kesaj Kontrate, sipas Marreveshjeve perkatese rast pas rasti.
6. Secili prej Anetareve do te procedoje ne menyre te ndershme dhe ne mirebesim, ne menyre qe te mund t'i lejoje pales tjeter qe te kryeje detyrat e saj ne perputhje me qellimin, te drejtat dhe detyrimet e marra persiper ne kete Kontrate.
7. Secili Anetar do te vere ne dispozicion te pales tjeter ne çdo kohe informacionin e nevojshem, raportimet e te dhenave dhe opinionet rreth Shoqerise se Thjeshte dhe sherbimeve te kryera prej tyre.
8. Pervercse kur parashikohet ndryshe ne kete kontrate, secili prej Anetareve, do te mbaje konfidenciale per sa eshte e mundur ndaj paleve te treta çdo veprimtari te Shoqerise se Thjeshte.



A2024053790295837720

## NENI 9

### PËRFAQËSIMI LIGJOR-ADMINISTRIMI

1. Shoqeria e Thjeshte do te menaxhohet nga dy Administratore. Emerimi i Administratoreve eshte per nje periudhe te pacaktuar dhe mandati i tyre mund te revokohet vetem me Vendimin e perbashket te Antareve te Shoqerise.
2. Administratoret e Shoqerise se Thjeshte jane:  
Z. Sokol Metoja, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Tirane, mbajtes i Leternjoftimit me Nr. Personal I20618075A; dhe  
Z. Roland Sinjari, shtetas shqiptar, lindur me 08.11.1984, ne Lushnje, banues ne Tirane, mbajtes i Leternjoftimit me Nr. Personal I41108079R.
3. Administratoret e shoqerise i ushtrojne te gjitha detyrat dhe pergjegjesite e tyre secili vec e vec, ne menyre te pavarur.
4. Administratoret do te perfaqesojne Shoqerine e Thjeshte vec e vec, ne menyre te pavarur ne te gjitha transakcionet e saj me persona te trete si dhe perpara cdo banke te nivelit te dyte ne Republiken e Shqiperise apo institucioneve te tjera financiare, prane gjykatave, enteve publike dhe private, cdo institucioni publik qendror dhe lokal, etj.
5. Administratoret do te kene te drejten te emerojne, me ane te autorizimit te thjeshte, pa formalitete te tjera, pale te treta si perfaqesues te posaçem te autorizuar per te ndermarre veprime te posaçme dhe te perfaqesojne Shoqerine e Thjeshte para Gjykatave ose Institucioneve te tjera publike, Bankave ose cdo enti tjetër publik apo privat te çfaredo natyre sipas nevojave te Shoqerise se Thjeshte.
6. Administratoret do te perfaqesojne Shoqerine e Thjeshte vec e vec, ne menyre te pavarur kundrejt klienteve apo punemarresve te ndryshem te Shoqerise se Thjeshte.

## NENI 10

### LIBRAT E KONTABILITETIT - SHPENZIMET - BILANCI

1. Shoqeria e Thjeshte do te mbaje librat e kontabilitetit dhe dokumentet, ne pajtim me ligjin ne fuqi aktualisht ne Shqiperi.
2. Bilanci Pasqyrat Financiare te Shoqerise te Thjeshte do te pergatiten me 31 Dhjetor te çdo viti. Bilanci do te hartohet dhe nenshkruhet nga Administratoret.
3. Shoqeria e Thjeshte do te perballoje te gjitha shpenzimet dhe te gjitha llojet shpenzimeve qe do te jene te nevojshme per zbatimin e Projektit deri ne mbarimin e afatit te Shoqerise te Thjeshte.
4. Kostot e Shoqerise te Thjeshte do te perfshijne, por nuk do te kufizohen, si vijon:
  - a. Pagat e perditshme, pagesat, perfitimet, shperblimet, kontributet e sigurimeve shoqerore, te gjitha llojet e shperblimeve, etj paguar per te gjithë anetarët e personelit te punesuar ne vendndodhjen e Projektit dhe per Projektin ne pergjithesi.



- b. Tarifat e qirase dhe te gjitha shpenzimet operative dhe te mirembajtjes te pajisjeve mekanike, instalimet fikse, etj, te cilat mund te jepen me qira nga Shoqeria e Thjeshte ne fushen e Projektit per te siguruar arritjen e qellimit te tij.
- c. Shpenzimet e udhetimit te bera nga persona te autorizuar te paleve kontraktuese, me kusht qe ato jane te nevojshme per permbushjen e nevojave te Shoqerise te Thjeshte.
- d. Te gjitha taksat, duke perfshire tatimin mbi te ardhurat, faturat dhe komisionet e pagueshme ndaj Shtetit, Bashkive, Komunave, dhe paleve te treta pavaresisht llojit dhe natyres se tyre, te cilat jane te lidhura me Shoqerine e Thjeshte.
- e. Te gjitha gjobot e mundshme dhe te gjitha llojet e humbjeve dhe shpenzimeve shtese te vendosura ne lidhje me Projektin qe do te zbatohet.
5. Te gjitha shpenzimet e Shoqerise te Thjeshte gjate zbatimit te Projektit jane "objekt miratimit" (me nenshkrim) nga ana e Administratoreve vec e vec, ne menyre te pavarur.

#### NENI 11

#### MARRËVESHJE TË TJERA

1. Eshte rene dakord veçanerisht se, nese ndonje anetar i Shoqerise te Thjeshte shperbehet, falimenton ose vihet ne likuidim te detyrueshem ose nje pale e trete ka arritur sukses kundrejt tij per drejten e likuidimit te kuotave, ky anetar duhet te njoftoje anetarin tjeter menjeherë dhe do te largohet nga Shoqeria e Thjeshte, menjehere, pa asnje formalitet tjeter, dhe anetari tjeter (qe mbetet) do te vendos nese do vazhdoje vetem aktivitetin e Shoqerise te Thjeshte deri ne realizimin e plote te qellimit te tij apo te perfshije anetare te tjere ne Shoqeri.
2. Palet kontraktuese shprehimisht dhe ne menyre specifike bien dakord dhe pranojne qe Administratoret do te ushtrojne te gjitha detyrat, autorizimet, veprimet, angazhimet, transaksionet, te drejtat dhe funksionet, dhe te gjitha aktet e çfaredo natyre, ne emer dhe per llogari te Shoqerise te Thjeshte, bazuar ne nje mandat dhe autorizim te posaçem qe i eshte dhene atyre nga palet kontraktuese ne menyre te parevokueshme, pa asnje kufizim, perveç ndonje rasti qe eshte permendur ne menyre specifike ketu.
3. Anetaret e Shoqerise te Thjeshte nuk do te kene te drejten te bejne shpenzime ne emer te Shoqerise te Thjeshte pa nje vendim paraprak me shkrim nga ana e Administratorit.

#### NENI 12

#### SHKAKU I ZGJIDHJES DHE NJOFTIMI

1. Perveç rasteve kur kjo Kontrate parashikon ndryshe, marredhenia kontraktore midis Paleve mund te zgjidhet ne keto raste:
- a. Me marreveshje te perbashket te shkruar nga secili nga Palet;



A2024053790295837720

b. Me zgjidhje te njeanshme nga njera nga palet duke njoftuar me shkrim palen tjeter per zgjidhje, nese Pala tjeter eshte ne mospermbushje te te detyrimeve te marra persiper ne kete kontrate.

### NENI 13

#### ZGJIDHJET E MOSMARRËVESHJEVE

Palet bien dakort qe çdo mosmarrveshje qe mund te linde nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kesaj kontrate do te zgjidhet me mirekuptim nepermjet bisedimeve mes Paleve. Ne rast se bisedimet nuk do te japin rezultat, atehere konflikti do te zgjidhet nga Gjykata e Shkalles se Pare Tirane.

### NENI 14

#### LIGJI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI

Per sa i perket çeshtjeve qe kjo Kontrate nuk i rregullon shprehimisht, ato do te rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, ligje, dispozita e norma te tjera qe jane ne fuqi, te cilat drejteperdrejte apo terthorazi lidhen me objektin e kesaj kontrate.

### NENI 15

#### FORCA MADHORE

1. Asnje Pale nuk do te mbaje pergjegjesi per mospermbushjen e detyrimeve te percaktuara ne kete Kontrate per shkak te Forces Madhore dhe ne menyre te vecante per shkaqet si, revolucione, çrregullime, levizje popullore, lufta, greva, zjarre, permbytje, termete, fenomene te natyres, shtetezime, shpronese, ose akte te pushtetit qendror apo lokal qe kufizojne lirine personale apo te sipermarries.

2. Ne rast te Forces Madhore, Pala qe eshte penguar ose eshte vonuar ne permbushjen e detyrimeve te saj duhet te njoftoj palen tjeter pa hezitim, duke komunikuar per te gjitha detajet e plota te Forces Madhore si dhe arsyet perse pengohet Pala ne permbushje te detyrimit, ose vonesen e saj. Pala duhet qe te beje perpjekje e arsyeshme per te zbutur efektet e ngjarjes ne menyre qe te zbatoje Kontrate dhe detyrimet sipas Kontrate.

3. Pas perfundimit te ngjarjes, Pala e prekur duhet sa me shpejt te jete e arsyeshme, te filloje zbatimin/permbushje e detyrimeve sipas Kontrates. Ne rast se efektet e Forces Madhore vazhdojne per nje perudhe prej 60 ditesh ose me shume, secila nga Palet ka te drejte per te kerkuar zgjidhjen e Kontrates me efekt te menjehershme duke njoftuar me shkrim.

### NENI 16

#### KONTRATA E PLOTË/NDRYSHIMET

1. Çdo kusht apo formulim qe mund te sjelle paqartesi do te interpretohet ne kontekstin e teresise se Kontrates dhe brenda qellimit qe i beri Palet te nenshkruajne kete Kontrate.





A2024053790295837720

2. Kjo Kontrate perben te gjithë Kontraten dhe zevendeson te gjitha kontratat e meparshme, me goje ose shkrim, mes paleve ne lidhje me thelbin e saj dhe mund te jete e ndryshueshme vetem me akt te nenshkruar nga te dyja Palet.

#### NENI 17

#### KALIMI I TË DREJTAVE

Asnjera nga Palet nuk do kete te drejte te kaloje ose transferoje te drejta, perfitimet ose detyrimet sipas kesaj Kontrate pa marr pelqimin paraprak me shkrim te Pales tjeter.

#### NENI 18

#### KONFIDENCIALITETI

1. Ne perputhje me kete Kontrate, secila nga Palet nuk duhet t'i beje me dije Informacione Konfidenciale, paleve te treta, pa marre nje miratim paraprak te shkruar nga pala tjeter. Detyrimi per konfidencialitet nuk do te zbatohet per informacionet konfidenciale qe i behen me dije organeve menaxhuese te Paleve, punemarresve, drejtoreve, keshilltareve ose agjenteve te pales ne nevojte per te njohur bazen, me kusht qe pala tjeter ne çdo rast do te mbaje pergjegjesi per çdo shkelje te detyrimeve sipas klauzoles.

2. Pavec kesaj, detyrimi per konfidencialitet nuk do te zbatohet ne rast se Pales i kerkohet sipas ligjit te zbatueshem, ose vendimit gjyqesor dhe administrativ qe t'i beje te ditur informacionin paleve te treta. Sidoqofte ne keto raste vetem ne masen e parashikuar nga ligji i zbatueshem, vendimi gjyqesor ose administrative, do te behet me dije.

#### NENI 19

#### HYRJA NË FUQI DHE AMENDIMET

1. Kjo kontrate hyn ne fuqi ne ditën e nenshkrimit te saj nga Palet.

2. Cdo amendim i kesaj Kontrate duhet te jete me shkrim dhe e nenshkruar nga perfaqesuesit e autorizuar te seciles Pale.

#### NENI 20

#### GJUHA DHE KOPJET

1. Kjo Kontrate eshte hartuar ne gjuhen shqipe.

2. Kjo kontrate u hartua ne 4 (kater) kopje origjinale.

Kontrata e mesiperme u hartua nga une, Noterja, sipas vullnetit te Paleve kontraktore, te cilat pasi e lexuan dhe e kuptuan ate, e firmosin para meje, dhe une noterja e vertetoj kete kontrate sipas ligjit te zbatueshem shqiptar.



A2024053790295837720

## NENI 21

### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata, u lexua nga une Noterja me ze te larte dhe ne menyre te qarte ne prani te paleve kontraktuese, te cilet me deklaruan se e kuptuan permbajtjen e saj dhe meqenese ajo shpreh vullnetin e tyre te lire e te plote, u njohen dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nenshkruajne ate rregullisht perpara meje Noteres.

Une Noterja, verifikova identitetin e paleve kontraktuese nepermjet dokumenteve te identitetit dhe pasi e gjeta permbajtjen e aktit noterial te mesiperm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Per Noterine", vertetoj nenshkrimin e tyre.

Ne zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te dhenave Personale", une Noterja deklaroi se do te ruaj dhe perpunoj te dhenat personale te subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

## PALËT

### "MS CONSTRUCTION" SHPK

Përfaqësuesi ligjor

Sokol Metoja

*Sokol Metoja*  
*[Signature]*



### "RS CONSTRUCTION & ENGINEERING" SHPK

Përfaqësuesi ligjor

Roland Sinjari



*[Signature]*  
*NOTERE*  
*Majlinda E. Demollari*  
*NP7: 741604007*  
*Titulli: Noterë*


**NOTERE**  
**MAJLINDA DEMOLLARI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MAJLINDA DEMOLLARI  
ADRESA NJESIA ADMINISTRATIVE  
NR.5, RR. VASO PASHA, GODINA NR.  
1, APARTAMENTI NR.3, HYRJA  
NR.10  
TEL: 0682061560



# KONTRATA TË TJERA

(SHITESË KONTRATE)

Nr. repertori: 8481

Nr. koleksioni: 2817

Tirane më 23/10/2024

Majlinda  
Demollari

Firmosur elektronikisht nga  
NISA me certifikatën  
Majlinda Demollari  
Data: 2024.10.23  
10:14:26+02:00

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29.07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9387, date 10.03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë", i ndryshuar



A2024053790304013315

\*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë

Majlinda E. Demollari  
Taksa e Pallas  
U. Pasha



A2024053790304013315

NOTERE MAJLINDA E. DEMOLLARI  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË  
RR. "VASO PASHA"

AMENDIM  
KONTRATË E SHOQËRISË SË THJESHTË

Në Tiranë, sot më datë 31.0.2024 (dymijë e njëzetë e katër), para meje, Noteres **Majlinda E. Demollari**, anëtare e Dhomës Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore, Tiranë, me zyrë në adresën, Njësia Adm. nr. 5, Rr. "Vaso Pasha", godina nr. 1, apartamenti nr. 3, hyrja nr. 10, Tiranë, u paraqitën për amendim të kontratës së punës personalisht palët kontraktuese:

**Shoqëria "MS CONSTRUCTION SHPK"**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M11923006V, me adresë Rruga "Qemal Stafa", Pallati 25, Hyrja 4, Apartamenti 4, përballë Qendrës Lincoln, njësia Bashkiake Nr.8, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Sokol Metoja, atësia Mustafa, amësia Bukuriye, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Blv. Zhanë D'ark; Nd. 107; H. 1; Njësia Administrative Nr. 3; Njësia Bashkiake Nr. 3; 1005; Tiranë, lindur më 18/06/1982, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032706806 dhe nr. personal I20618075A.

**Shoqëria "RS CONSTRUCTION & ENGINEERING" SHPK**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M11609022Q, me adresë Rruga Ismail Qemali, Ap.22, Nr. Pasurie 2/827+1-22, Zona Kadastrale 8270, Vol.81, Fq 234, përfaqësuar nga Administratori Roland Sinjari, atësia Kastriot, amësia Pranvera, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnjë, Lushnje dhe banues në TIRANË, me adresë Ndre Mjeda; Nd. 53; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 08/11/1984, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035787089 dhe nr. personal I41108079R.

Une Noterja, verifikova identitetin e paleve kontraktuese nepermjet dokumenteve te identitetit dhe pasi e gjeta permbajtjen e aktit noterial te mesiper, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Per Noterine", vertetoj nenshkrimin e tyre.

Ne zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te dhenave Personale", une Noterja deklaroi se do te ruaj dhe perpunoj te dhenat personale te subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Palët e mësipërme kanë lidhur një kontratë te thjeshte, me numër 8375 rep., dhe nr. 2761 kol., datë 18.10.2024, para meje Noteres Majlinda E. Demollari.

Tashmë, referuar kontratës bazë (kontrata e shoqërisë së thjeshtë), palët kanë rënë dakord të amendojnë sërish nenin "7", mbi Pjesëmarrjen në Shoqërine e Thjeshtë, si më poshtë:



**Neni 7 ISHTE:**

**PJESËMARRJA NË SHOQËRINË E THJESHTË**

1. Përqindjet e kontributit të Palëve në Shoqërinë e Thjeshtë do të jenë:

a) Anëtari I Shoqëria "MS CONSTRUCTION" SHPK-50%

b) Anetari II Shoqëria "RS CONSTRUCTION & ENGINEERING" SHPK-50%

2. Të njëjtat kuota pjesëmarrje do të aplikohen gjithashtu në rastin kur Shoqëria e Thjeshtë ndërmerr të kryejë çdo punë të re ose shtesë për këtë Projekt në çdo mënyrë.

3. Anëtarët bien dakord se garantimi i detyrimeve kundrejt të tremeve lidhur me pjesëmarrjen me sipër si dhe fitimi do të ndahet midis tyre sipas përqindjes së pjesëmarrjes së parashikuar këtu më sipër.

4. Ndalohet rreptësisht për të zgjeruar Shoqërinë e Thjeshtë përmes pjesëmarrjes së një apo më shumë anëtarëve shtesë në të pa marr paraprakisht pëlqimin nëpërmjet vendimit unanim të të dy anëtarëve të Shoqërisë së Thjeshtë.

5. Asnjë nga palët kontraktuese nuk ka të drejtën për të transferuar tek një palë e tretë, në asnjë mënyrë dhe për çfarëdo arsye, kuotat e saj të pjesëmarrjes në Shoqërinë e Thjeshtë, dhe as nuk ka të drejtë të transferojë të drejtat e veta që rrjedhin nga kjo Kontratë e Shoqërisë të Thjeshtë, pa miratimin paraprak të veçantë dhe me shkrim të Anëtarit tjetër.

**Neni 7, BËHET:**

**KAPITALI DHE PJESËMARRJA NË SHOQËRINË E THJESHTË**

1. Kapitali i Shoqërisë është i përbërë nga kontributi i anëtarëve themelues në vlerën 100,000 (një qind mijë) lekë.

2. Përqindjet e kontributit të Palëve në Shoqërinë e Thjeshtë do të jenë:

a) Anëtari I Shoqëria "MS CONSTRUCTION" SHPK-50%

b) Anetari II Shoqëria "RS CONSTRUCTION & ENGINEERING" SHPK-50%

3. Të njëjtat kuota pjesëmarrje do të aplikohen gjithashtu në rastin kur Shoqëria e Thjeshtë ndërmerr të kryejë çdo punë të re ose shtesë për këtë Projekt në çdo mënyrë.

4. Anëtarët bien dakord se garantimi i detyrimeve kundrejt të tremeve lidhur me pjesëmarrjen me sipër si dhe fitimi do të ndahet midis tyre sipas përqindjes së pjesëmarrjes së parashikuar këtu më sipër.

5. Ndalohet rreptësisht për të zgjeruar Shoqërinë e Thjeshtë përmes pjesëmarrjes së një apo më shumë anëtarëve shtesë në të pa marr paraprakisht pëlqimin nëpërmjet vendimit unanim të të dy anëtarëve të Shoqërisë së Thjeshtë.

6. Asnjë nga palët kontraktuese nuk ka të drejtën për të transferuar tek një palë e tretë, në asnjë mënyrë dhe për çfarëdo arsye, kuotat e saj të pjesëmarrjes në Shoqërinë e Thjeshtë, dhe as nuk ka të drejtë të transferojë të drejtat e veta që rrjedhin nga kjo Kontratë e Shoqërisë të Thjeshtë, pa miratimin paraprak të veçantë dhe me shkrim të Anëtarit tjetër.



Bashkëlidhur këtij amendimi janë:

1. Ekstrakti i thjeshtë i shoqërisë “MS Construction” sh.p.k dhe “RS CONSTRUCTION & ENGINEERING” sh.p.k.
2. Fotokopja e letërnjoftimit të Administratorëve të Shoqërisë.

Kjo kontratë printohet në 4 (katër) kopje.

Palët vërtetojnë që kanë marrë njohuri të plotë dhe e kanë kuptuar këtë amendim kontrate, dhe me vullnetin e tyre të lirë, e nënshkruajnë pa vërejtje para meje noteres, sipas ligjit.

### PALËT

“MS CONSTRUCTION” SHPK

Përfaqësuesi ligjor

Sokol Metoja



“RS CONSTRUCTION & ENGINEERING” SHPK

Përfaqësuesi ligjor

Roland Sinjari



NOTERE  
MAJLINDA E. DEMOLLARI

NOTERE  
MAJLINDA E. DEMOLLARI  
Kodi: K41606040X  
Tel: 0682061560

## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	M11923006V
2. Data e Regjistrimit	23/07/2021
3. Emri i Subjektit	MS Construction
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	21/07/2021
6. Kohëzgjatja	Nga: 21/07/2021
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga "Qemal Stafa", pallati 25, hyrja 4, apartamenti 4, perballe Qendres Lincoln. Njesia Bashkiake nr.8, Tirane
8. Kapitali	100,000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Ndertime te ndryshme kulturore,shitetore,shendetesore,bujqesore,fabrika,uzina, banesa etj.Projektme,instalime,punime restaurimi etj. Veprimtari ne fushen e transportit,te mallrave brenda dhe jashte vendit,me mallrat te vete shoqerise dhe te te treteve. Import-eksport ne pergjithesi brenda dhe jashte vendit. Import-eksport mobilje, veshje MBF, mobilim sallash konferencash, parket, moket. Ndricim, import- eksport, ndricim tavanesh. Veprimtari ne fushen e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis dhe auditimin mjedisor, veprimtarite e lidhura me mbrojtjen kunder zjarrit dhe auditimit te energjise.Grumbullim dhe transportim te mbetjeve inerte. Ndertim ujesjellesa, kuz, mbrojtje lumore, diga, etj.Aplikim dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i te gjitha Lejeve, Licencave, Autorizimeve dhe Miratimeve paraprake/ perfundimtare, te cilat mundesojne ndertimin e objekteve te reja gjeneruese te energjise elektrike te cilat shfrytezojne burimet e rinovueshme te energjise si dielli, era, uji, etj, si dhe i veprave te tyre ndihmese, dhe zhvillimin e ketyre aktiviteteve ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise; Implementimi, menaxhimi i projekteve gjeneruese te energjise elektrike, te cilat shfrytezojne burimet e rinovueshme te energjise si dielli, era, uji, etj, si

	<p>dhe i veprave te tyre ndihmese, i dhe shfrytezimi operimi dhe mirembajtja e tyre; Importi dhe eksporti i mallrave e paisjeve te teknologjive te ndryshme ne fushen e energjise elektrike, qe perdoren per ndertimin, mirembajtjen dhe menaxhimin e centraleve/sistemeve/imjanteve fotovoltaike,eolike, hidrike (perfshire panelet diellore, turbinat e eres, inverterat, transformatoret, linjat e transmetimit/ shperndarjes, dhe gjithë aksesoret/ pajisjet e tjera te konvertimit, transmetimit, sinjalizimit, monitorimit, mbrojtjes, transmetimit te te dhenave), etj; Shitja e energjise elektrike me shumice dhe/ ose pakice tek operatorët publik apo privat, pjesemarresit e tregut te energjise elektrike, perfshire ketu tregtaret, furnizuesit, konsumatorët e medhenj/ te vegjel, vendas apo te huaj, nepermjet platformave shteterore apo private, kontratave bilaterale apo marreveshjeve, te njohura, certifikuara, licencuara, miratuara nga organeve kompetente/pergjegjese dhe entitetet perkatese ne fushen e Bletja e energjise' elektrike me shumice dhe/ ose pakice nga operatorët publik apo privat, pjesemarresit e tregut te energjise elektrike, perfshire tregtaret, furnizuesit, vendas apo te huaj, nepermjet platformave shteterore apo private, kontratave bilaterale apo marreveshjeve, te njohura,certifikuara, licencuara, miratuara nga organet kompetente/pergjegjese dhe entitetet perkatese ne fushen e energjise elektrike; Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve per te cilat eshte krijuar. I cili nuk ndalohet me ligj.</p>			
<p>10. Administratori/ët 10.1 Afati i emërimit</p>	<p>Sokol Metoja</p> <table border="1" data-bbox="722 1361 1522 1417"> <tr> <td data-bbox="722 1361 1121 1417">Nga: 26/01/2023</td> <td data-bbox="1129 1361 1522 1417">Deri: 26/01/2028</td> </tr> </table>		Nga: 26/01/2023	Deri: 26/01/2028
Nga: 26/01/2023	Deri: 26/01/2028			
<p>11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)</p>				
<p>12. Ortakët 12.1 Vlera e kapitalit 12.2 Numri i pjesëve 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)</p> <p>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</p>	<p>SokolMetoja</p> <table border="1" data-bbox="722 1574 1522 1619"> <tr> <td data-bbox="722 1574 1121 1619">Para: 50.000,00</td> <td data-bbox="1129 1574 1522 1619">Natyre:</td> </tr> </table> <p>1,00</p> <p>50,00</p>		Para: 50.000,00	Natyre:
Para: 50.000,00	Natyre:			
<p>13. Ortakët 13.1 Vlera e kapitalit 13.2 Numri i pjesëve</p>	<p>RediStruga</p> <table border="1" data-bbox="722 1888 1522 1933"> <tr> <td data-bbox="722 1888 1121 1933">Para: 50.000,00</td> <td data-bbox="1129 1888 1522 1933">Natyre:</td> </tr> </table> <p>1,00</p>		Para: 50.000,00	Natyre:
Para: 50.000,00	Natyre:			



13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)	
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: MS Construction E-Mail: s_metoja@yahoo.com Telefon: 0692029400
16. Statusi:	Aktiv

Datë: 22/10/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga



## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT " SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	M11609022Q
2. Data e Regjistrimit	09/04/2021
3. Emri i Subjektit	RS CONSTRUCTION & ENGINEERING
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	07/04/2021
6. Kohëzgjatja	Nga: 07/04/2021
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane Rruga Ismail Qemali, Ap.22, Nr. Pasurie 2/827+1-22, Zona Kadastrale 8270, Vol.81, Fq 234
8. Kapitali	98.700.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00
9. Objekti i aktivitetit	Sherbime hotelerie, Qiradhenie, Bar-Restorant, Parkim, kend lojrash, qender argetimi per femije te te gjitha moshave, qender per zhvillim te lojrave sportive dhe jo sportive, sherbime pastrimi (perfshire edhe lavazh automjete) Investime ne fushen e pasurive te paluajtshme dhe ndertimit; Projektim, mbikeqyrje dhe zbatim i punimeve ndertimore te cfaredolloj. Shitje, blerje, dhenie me qira e pasurive te paluajtshme. Ofrimi i sherbimeve te konsulences ne fushen e menaxhimit dhe marketimit te pasurive te paluajtshme, Import-eksport te mallrave te ndryshme industrial, materiale ndertimi, hidrosanitare, makineri te cdo lloji, si dhe shitjen dhe blerjen e tyre me shumice dhe pakice brenda dhe jashte Shqiperise. Ndermjetesimi per shitjen dhe marketimin e pasurive te paluajtshme dhe aseteteve te ndryshme. Sherbime konsulence ne fushen e menaxhimit dhe marketimit te produkteve rezidenciale, komerciale... etj., dhe aseteteve. Aktivitete te vleresimit te pronave dhe aseteteve; Sherbime marketing, marredhenieve me publikun, ekspertize shitje, menaxhimi i prones, ndermjetesim qiradhenie, sherbime te studimit te tregut, sherbime te pas shitjes, ndjekja e pagesave te klienteve, mbajtja dhe menaxhimi i data bases se klienteve, mbajtja e marredhenieve me klientet. Veprimtari ekonomike ne fushe e real estate (pasurive te paluajtshme). Negocime, ndermjetesime, perfaqesime te te treteve ne fushen e real estate si ne tregun e brendshem ashtu edhe ne

ate nderkombetar. Shitje, blerje, dhenie me qira te te gjitha llojeve te pasurive te paluajtshme, brenda dhe jashte vendit, si dhe gdo transaksion tjetër ne funksion te permbushjes se objektit te veprimtarise ne fushen e real estate, midis personave fizike, personave juridike private dhe publike si dhe nga shteti si dhe cdo veprim tjetër i ligjshem qe ka te beje me pasurite e paluajtshme. Shoqeria mund te kryej cdo operacion tregtar, e qe lidhen me pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme; operacione financiare dhe kredi marrje, te jape garanci te treteve, si edhe te bleje dhe shes, ose marr me qira ndermarrje, dege ndermarrjesh, si dhe te kete pjesemarrje ne shoqeri, ente, konsorciume te themeluara apo ne themelim e siper qe kane objekt te njejte ose te ngjashem me te vetin, por gjithsesi funksional per arritjen e qellimeve te shoqerise. Shoqeria mund edhe te jape garanci reale dhe/ose personale, te vendose pengje, te dale dorezanese apo te vendose hipoteke edhe ne favor te te treteve. Gjithashtu, Shoqeria mund te kryeje cdo veprim apo operacion tjetër qe ka te beje me pronen e paluajtshme, te luajtshme, cdo veprim apo operacion tjetër komercial, industrial e financiar, te dobishem apo plotesues ndaj permbushjes se objektit te Shoqerise, me kusht qe aktivitetet e mesiperme te mos jene ne kundërshtim me objektin e Shoqerise. Tregtim me shumice e pakice, import-eksport i bimeve dekorative dhe luleve, i makinerive dhe i pajisjeve te ndryshme per kopshtari. Projektimi dhe zbatimi i veprave dekorative ne lidhje me kopshtarine dhe kopshtaret, si dhe cdo veprimtari tjetër ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme. Aktivitet ne fushen e realizimit te veprave te infrastruktures si rruge, 4 sistemime perforcuese-mbajtese, germime etj. Prodhim betony. Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, dhe te gjitha veprave te tjera madhore, ujesjellesave, Ujrave mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, ndertimin dhe rehabilitimin e veprave ujites, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike. rikonstruksione te veprave te artit, montimet e konstruksioneve metalike; Vleresimin e pasurive te paluajtshme. Hartimi i raporteve te vleresimit te ndikimit ne mjedis, per te kryer auditimin mjedisor, per hartimin e ekspertizave per problem mjedisor.

Kopje

	Veprimtari ne fushen e mbrojtjes nga zjarri te ndertesave te cdo lloji, hartimi i akteve te ekspertizes per zjarret e rena. Sherbim konsulence, studime urbane, sherbime ne planifikim urban, transporti, topografike, gjeologjike, hidrogeologjike, infrasrukture ambjentale, projektim objektesh civile, arsimore, sportive, industriale, bujqesore ushtarake, infrastrukture. Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh. Import, eksport i mallrave industriale, ushqimore, bujqesore, materiale ndertimi, materiale druri te perpunuar e te paperpunuar, grumbullim e perpunim te bimeve mjekesore, tregtim mallrash te cdo lloji me shumice e pakice, transport nacional e nderkombetare te mallrave dhe pasagjereve, komisioner, agjent tregtare e doganore, tregtim import eksport te mallrave me shumice e pakice, elektrike, elektronike, sanitare. Grumbullim transportm i ujrave te ndotur	
10. Administratori/ët	Roland Sinjari	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 07/04/2021	Deri: 07/04/2026
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Drejtuesi teknik (nëse ka)	Roland Sinjari	
12.1 Afati i emërimit	Nga: 05/05/2021	Deri:
13. Ortakët	Xhensila Sinjari	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 49.350.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		
14. Ortakët	Roland Sinjari	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 49.350.000,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	1,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)		
15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Vlore Vlore Radhime, Nr.Pasurie nr. 209/3/4, Zona Kadastrale 3140, Vol. 16, Fq.237	
16. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	E-Mail: rlndsinjari@yahoo.com Telefon: 0692534579	

17. Statusi:	Aktiv
--------------	-------

Datë: 18/10/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga Web

